



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Olti Trasing shpk” të datës 28.04.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i shkollës 7 shtatori - Invertarizimi” me nr. të prokurimit 616-25-6903-1-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Olti Trasing shpk” të datës 28.04.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i shkollës 7 shtatori - Invertarizimi” me nr. të prokurimit 616-25-6903-1-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik “Olti Trasing shpk” (tutje “parashtruesi”) me datë 28.04.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i shkollës 7 shtatori - Invertarizimi” me nr. të prokurimit 616-25-6903-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

*“Konstatimi i AK ne Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar të dates 23.04.2026 së Lista e Kontratave dhe dëshmitë e dërguara nuk i plotësojnë kriterin e kërkuar nga AK nuk qëndron për faktin së Grupi i OE: Olti Trasing SH.P.K & Fatini SH.P.K për ta plotësuar këtë kriter së bashku me ofertën ka dorëzuar Listën e Kontratave të kompanisë tone Olti Trasing SHPK, ku ne liste kemi shënuar vlerën e përgjithshme te realizimit te kontratës me AK- Komuna e Lipjanit-vetëm për mobile ne vlere prej 136,000.00 €. Listës ja kemi bashkangjitur Kontratën me AK – Komuna e Lipjanit, Paramasen me çmime ku janë të shënuara mobilët dhe Certifikatën – Raportin e Pranimet Teknike të datës 19.12.2022.*

*- Gjithashtu së bashku me ofertën kemi dërguar edhe Listën e Kontratave të realizura nga anëtari i Grupit – OE Fatini SHPK nga Shqipëria gjate periudhës kohore 30.07.2022 deri 30.07.2025 ne vlere totale të shprehura ne Euro 622,480.00€ (64,302,286 Lek sipas kursit të këmbimit të datës 30.07.2025). Kësaj lista ja kemi bashkangjitur te gjitha faturat që gjëndërohen nga sistemi i Administratës Tatimore te Shqipërisë për çdo shitje të mobileve për kopani private dhe persona fizik. Çdo fature e ka barkodin ku mund të verifikohet saktësia e të gjitha të dhënave të faturës. Këto fatura automatikisht sistemi i regjistron në Administratën Tatimore të Shqipërisë dhe bazuar na këto fatura sistemi automatikisht i kalkulon obligimet tatimore për çdo tatim pagues. Siç e cekem me larte çdo fature e ka barkodin dhe për këtë asnjë fature nuk nënshkruhet nga blerësi dhe shitësi por automatikisht sistem elektronik i administratës Tatimore të Shqipërisë e gjeneron faturën. Nese komisioni i vlerësimit te ofertave ka pasur pa qartësi, ka pasur mundësi që konforme nenit 59 dhe 72 të LPP dhe nenit 38 të RRPP 002/2022 si dhe nenit 10 të Udhëzuesit Nr. 002/2024 të kërkoj sqarime e jo direkt te na eliminoi nga aktiviteti i prokurimit.*

*- Konstatimi i AK në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar të dates 23.04.2026 së z. Endrit Kadriu nuk e plotëson kërkesën e AK- **Kërkesa 1** Një (1) Master Universitar në Dizajn të Brendshëm, minimum 5 vite përvojë pune ne fushën e njëjtë ose të ngjashme, nuk qëndron për faktin së në së bashku me ofertën kemi dërguar, Marrëveshjen, Diplomën CV dhe referencën për përvojën e punës në kompaninë tone Olti Trasing SH.P.K. Nese komisioni i vlerësimit të ofertave ka pasur pa qartësi, ka pasur mundësi që konforme nenit 59 dhe 72 të LPP dhe nenit 38 të RRPP 002/2022 si dhe nenit 10 të Udhëzuesit Nr. 002/2024 të kërkoj sqarime e jo direkt te na eliminoi nga aktiviteti i prokurimit. Për të ju dëshmuar së z. Endrit Kadriu ka punuar ne kompaninë tone Olti Trasing SH.P.K prej datës 01.08.2017 deri me datën 31.08.2023 së bashku me Kërkesën për Rishqyrtim po ju dërgojmë Pasqyrën e Trustit të z.Endrit Kadriu ku i keni te shënuara të dhënat e deklarimit të kontributeve në paga.*

*- Konstatimi i AK në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar të datës 23.04.2026 së z. Valon Jetullahu nuk e plotëson kërkesën e AK - **Kërkesa 2** Një (1) Baçelor i Arkitekturës së Interierit dhe Dizajnit të Mobileve minimum 3 vite përvojë pune në fushën e njëjtë ose të ngjashme, nuk qëndron për faktin së në së bashku me ofertën kemi dërguar, **Marrëveshjen, Diplomën, CV** për përvojën e punës në kompaninë **“Frasheri 1954” SHPK**. Nese komisioni i vlerësimit te ofertave ka pasur pa qartësi, ka pasur mundësi që konforme nenit 59 dhe 72 të LPP dhe nenit 38 të RRPP 002/2022 si dhe nenit 10 të Udhëzuesit Nr. 002/2024 të kërkoj sqarime e jo direkt të na diskriminoi dhe te na eliminoi nga aktiviteti i prokurimit. Për të ju dëshmuar së z. Valon Jetullahu i plotëson kërkesën e AK së bashku me Kërkesën për Rishqyrtim po ju dërgojmë Pasqyrën e Trustit të z Valon Jetullahu ka dëshmon së ka punuar në kompaninë **Musliu Brothers SH.P.K** prej muajt Prill 2023 deri Tetor 2023 dhe në kompaninë **“Frasheri 1954” SHPK**. ka punuar prej datës muajt Nëntor 2023 deri në muajt Dhjetor 2025.*

Konstatimi i AK në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar të dates 23.04.2026 së oferta jone nuk ka plotësuar kërkesën nr 6 - Operatori Ekonomik së bashku me ofertën duhet të dërgoj të Autoriteti Kontraktues Katalogun e prodhuesit për artikullin nr. 73 - Raft mur, nuk qëndron për faktin së ne së bashku me ofertën kemi dërguar katalogun komplet për të gjithë artikujt që AK ka kërkuar dhe se specifikat teknike të artikullit nr. 73 janë identike me kërkesën e AK. Nese komisioni i vlerësimit të ofertave ka pasur pa qartësi lidhur me specifikat e artikullit nr.73, ka pasur mundësi që konforme nenit 59 dhe 72 të LPP dhe nenit 38 të RRPP 002/2022 si dhe nenit 10 të Udhëzuesit Nr. 002/2024 të kërkoj sqarime e jo direkt të na diskriminoi dhe eliminoi nga aktiviteti i prokurimit.

- Konstatim i AK në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar të dates 23.04.2026 së pretendimi i OE për Certifikatat CE nga organi certifikues "Integra" nga Turqia është pjesërisht i bazuar, për neve është i pa qarte për faktin së ne letrën standarde te kompanisë tone është dashur të shënohen te dhënat lidhur me ofertën tone e jo pretendimet ankimore të OE: WOOD CORPORATION L.L.C.". Parashtruesi po ashtu ka parashtruar pretendime ankimore sipas të cilave oferta e tenderuesit te rekomanduar për kontratë është e papërgjegjshme për arsyet e prezantuara në kërkesën për rishqyrtim.

Sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar për arsyet si në vijim:



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT  
KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, TREPQES NR.2 – PRISHTINE

#### Letër standarde për tenderuesin e eliminuar

Data:  
Prishtinë

Për: GOE Grup i Operatorëve Ekonomik Olti Trasing SH.P.K.; Fatini SH.P.K., Bill Clinton, 10000, PRISHTINE, Kosovë  
Titulli: Ndërtimi i shkollës 7 shtatori - Inventarizim

Nr i prokurimit	616-25-6903-1-1-1
-----------------	-------------------

I nderuar z. Rama  
Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

[Tenderi i juaj] është i papërgjegjshëm

#### ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye: tenderi i juaj është i papërgjegjshëm pas rivlerësimit të këtij aktiviteti pas kërkesës për rivlerësim me ofertën tuaj:

Pretendimi: për Aneksin 7 të listës së kontratave të realizuara është i bazuar, pasi që GOE nuk ka arritur të dëshmojë sipas kërkesës dhe dëshmisë, sepse ka paraqitur vetëm lideri i grupit një kontratë të realizuar e cila është në vlerë prej 136,000 €, ndërsa anëtari tjetër i konsorciumit ka paraqitur vetëm fatura private të cilat nuk janë bindëse dhe të padëshmueshme mbi realizimin e tyre, sepse mungon referenca (emri dhe mbiemri i marrësit, numri kontaktues, si dhe transaksionet bankare), e që është në kundërshtim me kërkesën dhe dëshminë. Andaj, për këtë pikë pretendimi ankimor është i bazuar dhe GOE është e papërgjegjshme për këtë pikë.

PRETENDIMI II. GOE për këtë pikë ka paraqitur z. Endrit Kadriu, për të cilin nuk ka arritur të dëshmojë, pasi që Komisioni i rivlerësimit, bazuar në pretendimet e ankuesit dhe vendimin mbi rivlerësimin, pas verifikimit për të njëjtin në ofertën e tij, lidhur me z. Endrit Kadriu, për të cilin është paraqitur referencë mbi përvojën e punës nga "Olti Trasing", e lëshuar me datën 23.06.2025, konstaton se pretendimi i ankuesit është i bazuar, sepse nuk përputhet me CV-në e dorëzuar nga vetë inxhinieri, pasi në CV-në e tij të dorëzuar nuk figuron fare përvoja e paraqitur në referencën e lëshuar.

PRETENDIMI III. GOE për këtë pikë ka paraqitur z. Valon Jetullahu, për të cilin nuk ka arritur të dëshmojë, pasi që Komisioni i rivlerësimit, bazuar në pretendimet e ankuesit dhe vendimin për rivlerësim,

Faqe 3 nga 5

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks-gov.net

konstaton se pretendimi është i bazuar, pasi që GOE me ofertën e tyre nuk ka dëshmuar për përvojën e punës, por ka dorëzuar vetëm CV-në, diplomën dhe një parakontratë, ndërsa nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi mbi përvojën e punës sipas kërkesës dhe dëshmisë.

PRETENDIMI V. GOE, lidhur me pozicionin 73 sipas Aneksit 1 të specifikimit dhe paramasës, nuk ka arritur me ofertën e tij të dëshmojë se e posedon përmes katalogut të ofruar. GOE për këtë pikë ka paraqitur një pozicion të ngjashëm me dimensione të jashtme, por që nuk janë sipas kërkesës së AK-së (me një raft në mes). Andaj pretendimi është i bazuar dhe këtë kërkesë GOE nuk e ka plotësuar sipas kërkesës nr. 6 për pozicionin 73, si dhe pozicioni 61 nuk është sipas peshës së kërkuar.

Ndërsa, lidhur me pretendimin që një pjesë e produkteve të jenë të certifikuara me CE, përkatësisht pozicionet e artikujve 58, 59, 60, 61, 62, 64, 65, 66, 67, 69, 70, 71, 72, 73, 75, 76 dhe 80, për të cilat nuk janë të certifikuara me standardin evropian CE nga organi certifikues "Integra 96" nga Turqia, për këtë pretendim është pjesërisht i bazuar.

Bazuar në pretendimet e ankuesit dhe në të gjeturat pas rivlerësimit të ofertës, Komisioni i rivlerësimit konstaton se oferta e Grupit të Operatorëve Ekonomik Olti Trasing SH.P.K.; Fatini SH.P.K., Bill Klinton, 10000, PRISHTINE, Kosovë është e papërgjegjshme, për shkak se nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit (DT) dhe në Njoftimin për Kontratë.

së bashku me ofertën Sigurimin e Tenderit, sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë. Bazuar në Udhëzuesin nr. 001/2023 për Prokurimin Publik në rastet kur , Sigurimi i tenderit mungon dhe/ose nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde, e cila është pjesë e Dosjes së Tenderit (DT) tenderi refuzohet pa kërkuar sqarim të mëtejshëm. Oferta e juaj ka tejkalluar vlerën e parashikuar të kontratës.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

**Me respekt!**

**Sektori i Prokurimit**

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eliminuese të prezantuara në letrën standarde përmes të cilit parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, është gjetur që arsyet e evidentuara nga komisioni vlerësues për eliminimin e parashtruesit si të papërgjegjshëm janë të sakta, të matshme dhe të ligjshme. Rrjedhimisht është gjetur se eliminimi i parashtruesit është bërë në mënyrë të drejtë. Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me tenderuesin e rekomanduar është gjetur se përderisa vet parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të trajtohet fare si palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP. Pavarësisht kësaj është gjetur se oferta e dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar është në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat e DT si dhe specifikat teknike të DT. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 05.05.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.